



Pranuar / Dorezuar Punimjen/Prodato Received/Delivered	16.03.2023	3	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jednica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKMSTHCK	2742/2023		114



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.352/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Jeton Koca dhe Arben Mehmeti-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.352/2023 të datës 13.02.2023, të parashtruar nga ankuesi

në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 16.03.2023, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa A.nr.352/2023 e datës 13.02.2023, e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës, më datë 13.02.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokoli 1696/2023 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar nën shenjen A.nr.352/2023, kundër Vendimit me numër protokoli 24 të datës 31.01.2023 të Komisionit Përzgjedhës të Shërbimit Korrektues të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në mbështetje të dispozitave të Rregullos Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 21.02.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Shërbimi Korrektues i Kosovës, ndërsa kjo e fundit më datë 28.02.2022 ka përcjella shkresat lidhur çështjen ankimore.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit me numër të protokollit 1696/2023 të datës 13.02.2023 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër protokollit 24 të datës 31.01.2023 të Komisionit Përzgjedhës të Shërbimit Korrektues të Kosovës; Vendimin me numër protokollit 001/2 të datës 19.01.2023 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Njoftimin për rezultatet përfundimtare i datës 01.02.2023; Ankesën me numër protokollit 005 të datës 06.01.2023 të ankuesit; Njoftimin për rezultatet e vlerësimit për test me shkrim i datës 22.12.2022; Njoftimin për rezultatin e vlerësimit për intervistë me gojë i datës 23.12.2022; Njoftim për rezultatet përfundimtare i datës 23.12.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër protokollit 1961/2023 e datës 21.02.2023; Përgjigjen në ankesë me numër protokollit 2183/2023 e datës 28.02.2023; Konkursin e Brendshëm me numër protokollit 1024 i datës 11.10.202 për pozitën Udhëheqës i Njesisë për Siguri dhe Operativ (pavijon); Kërkesën për fillimin e rekrutimit i datës 12.09.2022; Listën e ngushtë për pozitën Udhëheqës i Njesisë për Siguri dhe Operativ (pavijon); Vendimin me numër protokollit 1279 të datës 05.12.2022 për themelimin e komisionit përzgjedhës; Testin me shkrim të ankuesit i datës 16.12.2022; Çelësin e testit me shkrim; Kërkesën për punësim të kandidatit G.A e datës 25.11.2022, Kontratën e punës për kohë të caktuar e datës 01.02.2018 për kandidatin G.A, Diplomën me Nr. 195/16 të datës 07.03.2026 për kandidatin G.A, Diplomën me Nr.02-611-1172 të datës 31.07.1997; Certifikatën e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega Lipjan e datës 15.11.2022; Vërtetimin e datës 15.11.2022 të Policisë së Kosovës; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2020 i datës 23.12.2022, Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021 për kandidatin G.A; Vërtetimin e datës 16.11.2022, Certifikatën për periudhën 07-11.11.2022 për kandidatin G.A; Kërkesën për punësim të ankuesit e datës 25.11.2022; Kontratë pune për kohë të pacaktuar e datës 06.09.2018 për ankuesin; Diplomën me Nr. 601 e datës 08.06.2015 për ankuesin; Certifikatën e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega Lipjan e datës 21.11.2022; Vërtetimin e datës 23.11.2022 të Policisë së Kosovës; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2020 i nënshkruar nga ankuesi më datë 12.01.2021; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021 të nënshkruar nga ankuesi më datë 25.01.2022; Vërtetimin e datës 25.11.2022; Referencën e punës të datës 25.11.2022, Certifikatën e trajnimit për periudhën 15.10-23.11.2018, 12.02-16.03.2018, 23-27.04.2015, 09.02.2022, 27-29.09.2010, 28.03-01.04.2011, 11-14.10.2021, 04.06.2004; Autorizim i datës 23.01.2020; Vendimin e datës 24.02.2023 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Ankesën e datës 15.02.2023 e ankuesit e parashtruar në Komisionin e Ankesave të SHKK-së.

Kolegji për Shqyrtimin dhe vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës, konstatoi se ankesa e ankuesit **është e palejuar, sepse:**

Nga administrimi i provave materiale rrjedhë së Shërbimi Korrektues i Kosovës më datë 11.10.2022 ka shpall Konkursin e brendshëm me numër reference MD/SHKK/019/11.10.2022, për pozitën Udhëheqës i Njesisë për Siguri dhe Operative (pavijon) për Qendrën e Paraburgimit (Korrektuese për Femra) në Lipjan, e në të cilin konkurs kishte aplikuar edhe ankuesi, dhe së i njëjti ishte përfshirë në të gjitha fazat e vlerësimit gjegjësit në testin me shkrim dhe në intervistën me gojë. Sipas Njoftimit të datës 23.12.2022 të Udhëheqësit të Personelit

lidhur me rezultatin përfundimtar, kandidati Gazmend Ahmeti ishte vlerësuar me gjithsej 76 pikë, duke u renditur si kandidati i parë, ndërsa ankuesi ishte vlerësuar me gjithsej 72.5 pikë, duke u renditur si kandidati i dytë.

Ankuesi i pakënaqur me rezultatin përfundimtar të datës 23.12.2022, brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në Komisionin e Ankesave të Shërbimit Korrektues të Kosovës, ndërsa ky i fundit me Vendimin me numër protokollit 001/2 të datës 19.01.2023 ka aprovuar pjesërisht ankesën e ankuesit, duke e obliguar Komisionin Përzgjedhës të bëjë rishqyrtimin dhe rivlerësimin e testit me shkrim për ankuesin dhe kandidatin Gazmend Ahmeti dhe të del më raport përfundimtar të vlerësimit. Komisioni Përzgjedhës duke vepruar sipas Vendimit me numër protokollit 001/2 të datës 19.01.2023 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, me Vendim me numër protokollit 24 të datës 31.01.2023, ka bërë rishqyrtimin e testit me shkrim të ankuesit dhe ka vlerësuar që për pyetjen Nr. 27 të testit më shkrim ankuesi duhet të vlerësohet me 2 pikë, ndërsa për pyetjen Nr. 41 dhe Nr. 44 ka vlerësuar se ankuesit duhet ti shtohen edhe nga një pikë në përgjigje të dhëna, duke ka lenë në fuqi vlerësimin e intervistës me gojë të datës 23.12.2022.

Njësia e Personelit të SHKK-së më datë 01.02.2023 ka bërë ripublikuar Rezultatin Përfundimtar lidhur me Konkursin e brendshëm me numër reference MD/SHKK/019/11.10.2022, për pozitën Udhëheqës i Njesisë për Siguri dhe Operative, sipas të cilit kandidati Gazmend Ahmeti është vlerësuar me gjithsej 76 pikë, duke u renditur si kandidati me shumë pikë, ndërsa ankuesi është vlerësuar me gjithsej 74.5 pikë, duke u renditur si kandidati i dytë.

Me tej nga shqyrtimi i provave të lëndës, Kolegji ka gjetur se ankuesi me datë 13.02.2023 ka parashtruar drejtpërdrejt ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil kundër Vendimit me numër protokollit 24 të datës 31.01.2023 të Komisionit Përzgjedhës, ndërsa më datë 15.02.2023 ka parashtruar ankesë në Komisionin e Ankesave të Shërbimit Korrektues të Kosovës kundër njoftimit të datës 01.02.2023 të Zyrës së Personelit lidhur me vlerësimin përfundimtar.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokollit 24 të datës 31.01.2023 të Komisionit Përzgjedhës në kuadër të Shërbimit Korrektues të Kosovës, pretendon që vlerësimi i testit me shkrim dhe intervistës me gojë është bërë në kundërshtim me legjislacionin përkatës në fuqi.

Në kuptim të pranushemrisë së ankesës, Kolegji i Këshillit ju referua Udhëzimit Administrativ MD-Nr.02/2022 për Gradat e Zyrtarëve Korrektues, Kontrollimin e së Kaluarës së Tyre, Periudhën Provuese dhe Promovimin, përkatësisht nenit 19 më të cili përcaktohet se: *"1. Kandidati që konsideron se i është shkelur ndonjë e drejtë gjatë procesit të rekrutimit dhe seleksionimit ka të drejtë ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e publikimit të rezultateve përfundimtare në komisionin për ankesa në Shërbimin Korrektues të Kosovës, 2. Kundër vendimit të komisionit të ankesave, pala e pa kënaqur ka të drejtë ankesë në afat prej 30 ditësh në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës nga dita e pranimi të vendimit"*. Andaj në kuptim të këtyre dispozitave ligjore, Kolegji konstaton se ankesa e ankuesit e parashtruar në Këshillin e

Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër Vendimit me numër protokolli 24 të datës 31.01.2023 të Komisionit Përzgjedhës është e palejuar, sepse ankuesi në rast të pakënaqësisë me vendimin e Komisionit Përzgjedhës, të njëjtin mund ta kundërshtoj më ankesë vetëm në Komisionin për Ankesa të Shërbimit Korrektues të Kosovës.

Për sa me sipër, Kolegji duke u bazuar në provat e lëndës të dërguara nga Shërbimit Korrektues i Kosovës, ka gjetur së ankuesi kundër vlerësimit përfundimtar të datës 01.02.2023 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Shërbimit Korrektues të Kosovës, i cili me Vendimin e datës 24.02.2023 ka refuzuar si të pabazuar ankesën e ankuesit, atëherë, nisur nga ky fakt si dhe duke i bazuar në nenin 19 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ MD-Nr.02/2022 për Gradat e Zyrtarëve Korrektues, Kontrollimin e së Kaluarës së Tyre, Periudhën Provuese dhe Promovimin, Kolegji konstaton së ankuesi mund ta kundërshtoj ligjshmërinë e Vendimit të datës 24.02.2023 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Shërbimit Korrektues, përmes ushtrimit të ankesës në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Theksuar si me lart, e në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Ky vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon së vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.352/2023

Avdyl BEKTESHI

[Signature]
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Ardita Haxhnikaj-DEMI

[Signature]
Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

